

**VENDIM**  
**Nr. 68, datë 11.5.2015**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIM IMPIANTI PRODHUES SI  
BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE TË SHOQËRISË “GAMA ENERGY” SHPK,  
PËR HEC “LENA 1”, “LENA 2” DHE “LENA 2A”, PËRKATËSISHT ME FUQI 1.95  
MW, 2.3 MW DHE 0.25 MW (FUQI TOTALE 4.5 MW)**

Në mbështetje nenit 39, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të “Rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.5.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Gama Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për kualifikim impianti prodhues si burim i rinovueshëm energjie për HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren e procedurave të certifikimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Është dhënë informacioni i kërkuar lidhur me klasifikimin e impiantit të ndërtuar.
- Është paraqitur raporti teknik, i cili përshkruan hollësisht teknologjinë gjeneruese që do të përdoret në impiantin e sipërpërmendur.
- Është paraqitur dokumentacioni teknik, i cili përshkruan karakteristikat bazë të të gjitha elementeve të impiantit prodhues.
- Janë paraqitur skicat e projektit të zbatimit.
- Nuk është paraqitur harta korografike e impiantit.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10, dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për kualifikim impianti prodhues të shoqërisë “Gama Energy” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga HEC “Lena 1”, “Lena 2” dhe “Lena 2A”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**